



**KUVENDI I KOMUNËS NË KAMENICË
DREJTORIA E KADASTRIT, GJEODEZISË DHE PRONËSISË**

RR E G U L L O R E

Mbi përcaktimin e lartësisë së kompenzimit për shërbimet të cilat i kryen Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë

Kamenicë, më 28 Shkurt 2002



KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI KOMUNAL
Nr. _____ më _____ 2002
K A M E N I C Ë

Në bazë të nenit 4.1 të Rregullorës 2000/45, mbi Vetqeverisjen e komunave të Kosovës dhe nenit 39, paragrafi 3 pika (e) dhe (j) të Statutit komunal, neneve 60.65. 73. 95.e 96(Gazeta zyrtare e Kosovës nr.12/80) të ligjit mbi matjet dhe kadastrin e tokave dhe Udhzimit administrative nr.SPPA/AKK/2001/2. mbi përcaktimin e pagesave për shërbimet të cilat i kryen Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë. Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2002 bie :

R R E G U L L O R Ë N M B I

Përcaktimin e lartësisë së kompenzimit për shërbimet të cilat i kryen Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e kompenzimit për shërbimet të cilat i kryen Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë- në tekstin e më tej më Drejtoria.

Neni 2.

Lartësia e kompenzimit për shërbimet kadastrale janë caktuar në përputhje me parimet e mbulimit të shpenzimeve. Ato do të caktohen mbi baza të mbulimit të plotë shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet për material dhe punë si dhe shpenzimet tjera gjat një periudhe mesatare të prodhimit. Shërbimet e Drejtorisë do të përcillen me një përshkrim përkatës dhe një Deklaratë mbi kushtet e pagesës dhe përdorimit, duke përfshirë dhënjen e të drejtës së autorit nëse kërkohet.

Neni 3.

Lartësia e kompenzimit për shërbimet e veqanta që nuk i përkasin aktiviteteve të rregullta kadastrale (psh. modeli digjital i lartësisë, digjitalizimi) do të caktohen nga Drejtoria para kryerjes së shërbimit. Drejtoria do të ofrojë një ofertë përkatëse për punën e tyre e cila do të përmbajë përshkrimin e shërbimeve të cilat do të kryhen dhe do të ipen për të caktuar kushtet e dhënjes, pagesës dhe shfrytëzimit duke përfshirë dhënjen e të drejtave të autorit nëse kërkohen.

Dispozitat e veçanta

Neni 4.

Çmimet e shërbimeve komunale kadastrale

4.1 Për shërbimet e mirmbajtjes së klasifikimit të tokave (klasët e kulturave):

Ndrimi i kulturës në një ngastër pa matje	10 euro
-për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të	5 euro
Ndrimi i kulturës në një ngastër pa matje	35 euro
-për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të	20 euro
Në fund pages i lëshohet vendimi	

4.2 Ndarje e ngastrave

Ndarja e një ngastrave në dy pjesë me matje të pjesës së re	60 euro
-për çdo pjesë tjetër	25 euro
Ndarja e ngastrës në pjesë të përcaktuara më parë	75 euro
Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë, për çdo pjesë tjetër	35 euro
Ndarja e një ngastrave në dy pjesë me matje të pjesës së re dhe përritje të kufijve	100 euro
-për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të	50 euro
Ngastrat e re regjistrohet në planin kadastral dhe regjister. Palës i lëshohet vendimi, kopja e planit dhe fleta poseduese	

4.3 Rilevimi i sipërfaqës së ndërtesave:

Ndërtesat individuale-për një ndërtesë	40 euro
Për çdo objekt tjetër në të njëjten ngastër	20 euro
Ndërtesat shumkatëshe-për një ndërtesë	120 euro
Objektet më të vogla që i takojnë ndërtesës shumkatëshe-për një objekt	20 euro
Ndërtesat e ndërlikuara-për një orë pune	10 euro
Palës i lëshohet vendimi, kopja e planit dhe fleta posedues.	

4.4 Përritja e kufijve të ngastrës

Për ngastrën me sipërfaqe gjerë në 0.50 ha	60 euro
Për ngastrën me sipërfaqe prej 0.50 gjerë në 1.00 ha	70 euro
Për ngastrën me sipërfaqe më të madhe se 1.00 ha-për çdo hektarë shtesë	35 euro
Për rrugë, hekurudhë, kanale në gjatësi gjerë në 100 m	50 euro
Për çdo meter gjatësi shtesë-edhe	0.50 euro
Palës i lëshohet vendimi dhe skica në të cilën shifet përritja e kufijve.	

4.5 Punët në matje sipas kërkesave të posaçme:

Bartja e planeve urbanistike në terren-për një ngastër	50 euro
Puna në zyrë për ndarjen e ngastrës sipas planeve urbanistike-për një ngastër	10 euro
Shënimi i ngastrës për ndërtim individual-për një ngastër	85 euro
Shënimi i vijës së rregulltë të rrugës-për një metër	0.50 euro
Palës i open këndet e shënimit të ngastrës gjegjësisht ndërtesës. Në rastin e ndarjes së ngastrës palës i lëshohet vendimi, kopja e planit dhe fleta poseduese	

4.6 Shënimi i kufijve në terren ma rastin e ekspropriimit:

Shënimi dhe matja e kufijve-për një metër gjatësi	0.50 euro
---	-----------

4.7 Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale:

Identifikimi i numrave të ngastrave dhe pronarëve të banesave apo rrënojave-për objektin e parë	10 euro
Për çdo objekt tjetër shtesë	5 euro
Identifikimi i një ngastrave pa matje-për një ngastër	10 euro
Identifikimi i një parcele-krahasimi i gjendjes së re me të vjetrën (në zyre)	15 euro
Pales i lëshohet konstatimi (këshilla) e Drejtoratit të Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësis	

4.8 Punët tjera gjeodezike

Përpilimi i skicave për pozitën e godinës në ngastër	10 euro
Përpilimi i skicave për pozitën e banesës në ndërtesë	10 euro
Matja e gypave, përçuesve elektrik dhe përçojave tjera-për një metër gjatësi	0.50 euro

4.9 Përpilimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa:

Ndarja e ndërtesës apo banesës në dy pjesë	35 euro
Për çdo pjesë tjetër-edhe	10 euro
Ndarja në dy pjesë e ngastrës e cila i takon ndërtesës	60 euro
Për çdo pjesë tjetër-edhe	15 euro
Përpilimi i skicave të banesave, ndërtesave banesore, lokaleve afariste, punëtorive, garazhave, etj	10 euro
Caktimi i sipërfaqes së ndërtesës apo pjesës së saj	17.5 euro
Pales i lëshohet vendimi, skica, kopja e planit dhe fleta poseduese.	

4.10 Kordinatat (y,x,z) dhe përshkrimi i pozitës së pikave gjeodezike, çmimi për një pikë

Kordinatat, lartësia mbidetare, përshkrimi i pozitës, çmimi për një pikë	2.5 euro
--	----------

4.11 Kopja e planit kadastral; paraqitja horizontale për një faqe të planit origjinal nga arkivi:

Për planin në shkallë 1:500	27.5 euro
Për planin në shkallë 1:1000	35 euro
Për planin në shkallë 1:2500	45 euro
Për planin në shkallë 1:5000	47.5 euro

4.12 Paraqitja vertikale e planit nga arkivi për një faqe:

Për planin në shkallë 1:500	17.5 euro
Për planin në shkallë 1:1000	22.5 euro
Për planin në shkallë 1:2500	27.5 euro
Për planin në shkallë 1:5000	30 euro

4.13 Paraqitja vertikale dhe horizontale e planit origjinal nga arkivi për një faqe:

Për planin në shkallë 1:500	45 euro
Për planin në shkallë 1:1000	55 euro
Për planin në shkallë 1:2500	70 euro
Për planin në shkallë 1:5000	115 euro

4.14 Paraqitja horizontale nga origjinali i punës për 1.00 ha:

Për planin në shkallë 1:500	3.5 euro
Për planin në shkallë 1:1000	2.5 euro
Për planin në shkallë 1:2500	1.5 euro
Për planin në shkallë 1:5000	1 euro

4.15 Fotokopja e planit:

Pagesa për punë	5 euro
Formati A4, çmimi për kopje	1.5 euro
Formati A3, çmimi për kopje	2.5 euro

4.16 Regjistri i punës:

Lëhimi i fletëve poseduese	2.5 euro
Vërtetimet tjera, për një vërtetim	5 euro
Regjistrimi, ndërrimi apo shlyerja e poseduesit të ri apo të drejtave mbri paluajtshmërit, për një regjistrim	5 euro

4.17 Punët tjera sipas kërkesave të palëve:

Puna në zyrë, për një orë	5 euro
Puna në terren, për një orë	10 euro

Dispozitat e veçanta

Neni 5.

5.1 Për punë në terren prej 15 Nëntorit gjerë më 15 Mars çmimet janë më të larta për 25%.

5.2 Pala duhet të paguaj apo sigurojë transportin për punë në terren. Nëse Drejtorati i Kadastrit, Gjeodezis dhe Pronësis siguron transportin, çmimi është 0.15 euro për 1 km.

5.3 Pala duhet paraprakisht të paguaj për shërbime, sipas pasqyrës prej 4.1-4.17 nëse Drejtorati i Kadastrit, Gjeodezis dhe Pronësis kërkon një gjë të tillë.

5.4 Pagesat dhe shpenzimet e transportit do t'i paguhen komunës drejtpërdrejtë.

5.5 Përveç nëse caktohet ndryshe, UNMIK-ut, Departamenteve SPPA, KFOR-it ose organizatave joprofitabile mund tu ipet sipas kërkesës në maksimum 50% zbritje nga pagesat e rregullta për shërbime. Komuna është e liruar nga pagesa për shërbime.

5.6 Kopjet digjitale të planeve kadastrale dhe ortofotot lëshohen nga AKK-ja. Çmimet janë dhënë në çmimoren e AAK-së, SPPA, AAK 2001/1.

Neni 6.

Dispozitat tjera për implementimin e këtij Udhëzimi Administrativ do të lëshohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Ankesat

Neni 7.

Ankesa kundër pagesës nga kjo çmimore duhet t'i përmbahet procedurës të paraparë në UNMIK Rreg/2000.45 neni 6, paragrafet 35.1, 35.7. Ankesat duhet t'i parashirohen me shkrim Shefit të ekzekutiv apo personit zyrtarë në kryerje të Shefit të ekzekutivit në afat prej një muaji nga dita kur pala që ankohet të jetë e njoftuar me vendimin. Autoriteti qëndrorë, sipas paragrafit 35.2 është Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Dispozitat karrantare

Neni 8.

Për kërkesat e bëra para aplikimit të kësaj çmimoreje, do të paguhet sipas çmimores në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Neni 9.

Për implementimin e kësaj Rregulloreje përgjegjëse do të jetë Drejtorati i Kadastrit, Gjeodezis dhe Pronësis.

Neni 10.

Kjo rregullore hynë fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës.



KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL

Ilir Surdulli
Ilir Surdulli